

HANDIKËS - MITROVICA

Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuar të Mitrovicës

HULUMTIM

rreth

**Monitorimit të zbatimit të Ligjit për Aftësimin,
Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me
Aftësi të Kufizuar**

Mitrovicë

Shkurt 2017

Monitorimi i zbatimit të ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar, Komuna e Mitrovicës

Botues: Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuar të Mitrovicës – Handikos Mitrovica

Drejtoreshë e hulumtimit: Myrvete Hasani

Udhëheqës i hulumtimit: Migjen Abrashi

Asistentet e hulumtimit: Merita Abrashi dhe Arbenita Zeneli

©2017 Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuar të Mitrovicës – Handikos Mitrovica

Të gjitha të drejtat e rezervuara

handikos_mitrovica@hotmail.com

Ky hulumtim është mundësuar me përkrahjen bujare të popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar - USAID. Përmbajtja e këtij hulumtimi është përgjegjësi e Handikos Mitrovica dhe nuk pasqyron pikëpamjet e USAID-it apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Hulumtimi ka dalur si rezultat i projektit “Pak nga Vetja; Shumë për PAK-un” i financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID dhe mbështetur nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim - ATRC.



PËRMBAJTJA

FALENDERIM	4
METODOLOGJIA	5
HYRJE.....	6
LIGJI PËR AFTËSIMIN, RIAFTËSIMIN PROFESIONAL DHE PUNËSIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA.....	10
QËNDRIMET E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR, FAMILJARËVE TË TYRE DHE AKTERËVE RELEVANT NGA INSTITUCIONET PUBLIKE, PRIVATE EDHE CIVILE NË LIDHJE ME GJENDJEN E PUNËSIMIT TË PAK-ut, PERCEPTIMET DHE SFIDAT E IMPLEMENTIMIT TË LIGJIT	12
Ndikimi I Projekti “Pak nga vetja ; shumë për PAK-un” tek Personat me Aftësi të Kufizuar	18
REKOMANDIMET.....	20
LISTA E SHKURTESAVE.....	21
LISTA E TË INTERVISTUARVE	22

FALENDERIM

Rajoni i Mitrovicës është njëri ndër vendet me numrin më të madh të papunëve dhe me probleme sociale dhe politike. Handikos Mitrovica ka afërsisht 600 anëtarë me aftësi të kufizuar të moshave të ndryshme, duke filluar prej fëmijëve e deri tek të rriturit dhe të moshuarit. Punësimi i personave me aftësi të kufizuar në sektorin publik, privat dhe civil në Kosovë, mbetet simbolik. Në bazë të ligjeve ekzistuese në fuqi, organet e administratës shtetërore, punëdhënësit e sektorit privat dhe publik, si dhe organizatat joqeveritare janë të obliguara që me kushtet e përshtatshme të punës, t'i punësojnë personat me aftësi të kufizuara. Sipas Ligjit për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, secili punëdhënës është i obliguar të punësojë një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë punëtorë. Në të kundërtën, punëdhënësi i cili nuk i përmbush detyrimet, obligohet të paguaj në buxhetin e Kosovës kontributet mujore.

Falë përkrahjes financiare nga USAID dhe mbështetjes së ATRC, Handikos Mitrovica gjatë vitit 2016 ka implementuar projektin “Pak nga vetja; shumë për PAK-un” në Mitrovicë, me qëllim të avokimit dhe promovimit të mundësive afariste dhe ndërmarjeve për trajnim/sistematizim të PAK-ut, programe trajnimi e punë/mësim të përgjithshme për PAK-un e papunë dhe monitorimit të zbatimit të ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar. Andaj, dëshiroj të shpreh mirënjohje dhe falënderim për të gjithë intervistuesit dhe pjesëmarrësit në takimet dhe aktivitetet tona, të cilët kanë qenë të gatshëm ta ndajnë kohën e tyre dhe të marrin pjesë në hulumtimin tonë. Në mënyrë të posaçme falenderoj donatorin USAID për përkrahjen financiare të projektit. Falenderoj udhëheqësin e hulumtimit Migjen Abrashi, si dhe anëtarët e stafit të Handikos Mitrovica, kontributi i të cilëve ka qenë jashtëzakonisht i rëndësishëm për realizimin e raportit.

Myrvete Hasani

Drejtoreshë Ekzekutive, Handikos Mitrovica

METODOLOGJIA

Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuar të Mitrovicës – Handikos Mitrovica ka shfrytëzuar informatat e mbledhura për ta hartuar metodologjinë hulumtuese me qëllim të monitorimit të zbatimit të ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar në Komunën e Mitrovicës.

Hulumtimi është zhvilluar me anë të pyetësorëve, takimeve dhe intervistave me përfaqësuesit e Institucioneve Publike, Private dhe Civile më Komunën e Mitrovicës në periudhën Nëntor – Dhjetor 2016. Kriteret për përzgjedhjen e pjesëmarrësve janë hartuar duke u bazuar në fokusin tek institucionet dhe ndërmarrjet që kanë mbi 50 të punësuar, andaj në këtë formë edhe është bërë dallimi ndërmjet pjesëmarrësve. Pos kësaj, në hulumtim janë përfshirë edhe intervistat me aktorë relevant të institucioneve që merren direkt apo indirekt me zbatimin e ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar. Handikos Mitrovica ka përdorur edhe burime të tjera të informacionit për të analizuar edhe probleme tjera që mund të kenë punëdhënësit në zbatimin e Ligjit në fjalë.

Këtij raporti iu është bashkangjitur edhe një pjesë e përshkrimit të ndikimit të projektit “Pak nga vetja; shumë për PAK-un” të implementuar nga Handikos Mitrovica dhe të përkrahur nga USAID dhe ATRC, tek Personat me Aftësi të Kufizuar në Mitrovicë. Projekti në fjalë i Handikos Mitrovica ka përmirësuar dukshëm gjendjen e personave me aftësi të kufizuar në Mitrovicë, posaqërisht 40 përfituesëve direkt të projektit.

Rekomandimet janë finalizuar në bashkëpunim me përfaqësuesit e institucioneve dhe shoqërisë civile përgjatë takimeve të programit.

HYRJE

Çdo person gëzon të drejtat universale të cilat janë të njohura me Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut dhe të drejtat e garantuara a për të gjithë personat me aftësi të kufizuara nga Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Personat më aftësi të kufizuar janë pjesë e natyrshme dhe integrale e shoqërisë si tërësi, të cilëve shteti duhet të ofroj garanci dhe mundësi që përmes formave të ndryshme, PAK të mund të kontribuojnë në zhvillimin e vendit tonë dhe në të njëjtën kohë të integrohen në proceset e ndryshme shoqërore, për përfshirjen dhe trajtimin e duhur të kësaj kategori pa asnjë lloj diskriminimi.

Korniza ligjore e cila merret me rregullimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, si në kuptimin e të drejtës së Bashkimit Evropian, e po ashtu edhe të drejtës ndërkombëtare, është mjaftë e gjerë.

Parimi i mundësive të barabarta në punësim dhe politika sociale, përbën një të drejtë universale e njohur nga Konventa e UN për personat me aftësi të kufizuar e miratuar në vitin 2006.

Qëllimi i kësaj Konvente është të nxisë, mbrojtë dhe të sigurohet që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre. Në veçanti Neni 28 i Konventës prezanton standardet e duhura të jetesës dhe mbrojtjes sociale, si dhe përcakton qartë të drejtën e personave me aftësi të kufizuar për përmirësimin e kushteve të jetesës, dhe për t'u siguruar qasjen e personave me aftësi të kufizuar në programet dhe përfitimet e pensionit.

Me nënshkrimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (UNCRPD), BE-ja ka miratuar Strategjinë Evropiane për personat me aftësi të kufizuar 2010-2020. Qëllimi i përgjithshëm i kësaj strategjie është që të fuqizojë personat me aftësi të kufizuara në mënyrë që ata të mund t'i gëzojnë të drejtat e tyre të

plota, dhe të përfitojnë plotësisht nga pjesëmarrja në shoqëri dhe në ekonominë evropiane.

Burimet kryesore ndërkombëtare dhe evropiane për të drejta e personave me aftësi të kufizuara në masë të konsiderueshme, janë inkorporuar në sistemin tonë juridik dhe janë të rregulluara me kushtetutë.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në kapitullin e II-të, Të drejtat dhe liritë themelore, promovon parimin se: “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme, e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës”.

Republika e Kosovës, duke respektuar parimet ndërkombëtare, përpos që ka garantuar juridikisht të drejtat dhe liritë e qytetarit, ka bërë edhe politika të zhvillimit, të ndërtimit dhe avancimit të mirëqenies për të gjithë qytetarët e vet, duke respektuar normat dhe parimet juridike.

Qeveria e Kosovës ka miratuar Strategjinë Nacionale për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara 2013 -2023 si dhe Planin e Veprimit të zbatimit të kësaj strategjie. Qëllimi i kësaj strategjie është që të promovojë, të mbrojë dhe të sigurojë zbatimin e plotë dhe të barabartë të të gjitha të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut nga të gjithë personat me aftësi të kufizuar, si dhe të kontribuojë në respektimin e dinjitetit të tyre të qenësishëm.

Njëra prej objektivave të kësaj strategjie është mbrojtja sociale që duhet të mbështet të gjithë personat në nevojë duke përmirësuar cilësinë e jetës së tyre. Kjo e drejtë dhe nevojë do të jetë sigurisht më e theksuar tek femrat dhe të moshuarit me aftësi të kufizuar, si kategori e cila konsiderohet më e rrezikuar në shoqëri. Instrument tjetër i rëndësishëm në aspektin e rregullimit ligjor të çështjes së përfitimit të pensione të financuara nga shteti për personat me aftësi të kufizuar është Ligji nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, i cili përfshin Skemën e Pensionit Bazik të Moshës, Skemën e Pensionit Kontribut pagues të Moshës, Skemën e Pensionit të Aftësisë së Kufizua, Skemën e Pensionit të Parakohshëm, si dhe rregullon çështjet e pensionit familjar dhe invalidor të punës, në rastet kur kontribuuesit lëndohen në punë apo fitojnë sëmundje profesionale.

Po ashtu është nxjerr edhe Ligji Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Ky Ligj ka për qëllim përkrahjen ligjore dhe institucionale për aftësim, riaftësimin, nxitjen dhe përgatitjen profesionale për punësim të përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuara duke u mbështetur në principet dhe tretmanin e mundësive të barabarta.

Qeveria e Kosovës, përkatësisht, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ka hartuar Strategjinë Sektoriale 2014-2020 dhe Planin Veprimit 2014-2016.

Objekt i kësaj strategjie është rritja e nivelit të punësimit dhe ngritja e aftësimeve profesionale sipas kërkesës së tregut të punës. Një ndër qëllimet e saj është edhe hartimi i masave dhe politikave zhvillimore për grupet e cënueshme, me theks të veçantë, punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Probleme tjetër i cili është evidentuar këto vitet e fundit drejta realizmin të drejtave të PAK, është mos zbatimi i Ligjit në mënyrë të plotë nr.03/L-019, për Aftësi, Riaftësim Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të kufizuara. PAK të cilët nuk janë përfitues të pensionit të plotë të caktuar sipas ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti, kanë të drejtën e punësimit dhe aftësimin profesional. Mungesa e njohjes së statusit të PAK sipas shkallës së aftësisë së mbetur për punë nga Komisionet Mjekësore të MPMS-se, ka rezultuar negativisht në punësimin dhe aftësimin profesional të PAK në tregun e punës. Mungesa e kategorizimit të PAK sipas shkallës së aftësisë së mbetur për punë si dhe përcaktimi i të drejtave të tyre varësisht prej kësaj shkalje, ka shfaqur po ashtu shumë pakënaqësi dhe reagime të shumta nga përfaqësuesit të OJQ të cilët i mbrojnë interesat e tyre. Me kategorizimin PAK sipas shkallës së aftësisë së mbetur për punë, do të krijoheshin edhe mundësitë e zbatimit me të mirë në praktik të ligjit për punësim dhe aftësim profesional të PAK.

Parimi i të drejtave të barabarta do të thotë se nevojat e secilit dhe çdo individ janë të një rëndësie të njëjtë, se ato nevoja duhet të jenë baza e planifikimit të shoqërisë dhe se të gjitha burimet duhet të përdoren në mënyrë të tillë që ti garantojnë çdo individ mundësi të barabarta për pjesëmarrje e në veçanti Personave me Aftësi të Kufizuara.

Në këtë kontekst Republika e Kosovës që nga kushtetuta me nenin e lartcekur ka vazhduar të hartoj dhe miratoj ligje, udhëzime, rregullore, strategji, plane dhe dokumente të tjera që shprehin në vazhdimësi obligimin e shtetit që të drejtat e personave me aftësi të kufizuara të përmbushen dhe respektohen në tërësi

Por, pavarësisht këtyre përpjekjeve Personat me Aftësi të Kufizuar ende vazhdojnë të jetojnë në kushte të vështira dhe akoma nuk i gëzojnë të drejtat si gjithë qytetarët e vendit.

Duke e përjetuar në lëkuren tonë të gjithë NE, shoqatat për personat me aftësi të kufizuar që sot shkruajmë në emër të të gjithë personave me aftësi të kufizuar (sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë Republika e Kosovës numëron afërsisht 150.000 persona me aftësi të kufizuar), ju kërkohet më tepër angazhim dhe përgjegjësi të gjitha autoriteteve të thirrura me ligj, që të ofrojnë shërbime adekuate në shëndetësi ,mbrojtje sociale ,arsimin gjithëpërfshirës dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar sepse vërtet jeta e personave me aftësi të kufizuar është e rënduar.

Shoqatat për Personat me Aftësi të Kufizuar kërkojnë jetësimin e obligimeve shtetërore që dalin nga infrastruktura ligjore sepse ligjet në letër nuk mund ta përmirësojnë jetës askujt.

LIGJI PËR AFTËSIMIN, RIAFTËSIMIN PROFESIONAL DHE PUNËSIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, gjatë mandatit të saj ka hartuar Ligjin Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara. Ky ligj rregullon kornizën e përgjithshme të punësimit të PAK-së.

Ligji garanton të drejtat, kushtet, mënyrat e aftësimit, riaftësimit profesional dhe punësimit të personave me aftësi të kufizuara, me qëllim të integritetit të tyre në tregun e hapur të punës

Si dhe Ligjin nr. 05/l -078 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/l-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, për veç tjerash me këtë Ligj do të bëhet edhe Vlerësimi i aftësisë së mbetur për punën nga ana e komisioni Mjekësor Medico- sociale.

Për zbatimin e drejt dhe efikas të këtij ligjit, MPMS-ja ka nxjerr tri (3)akte nënligjore.

- Udhëzimi Administrative Nr.03/2010, për procedurat e aplikimit për njohjen e të drejtave ne aftësim, riaftësim dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar,
- Udhëzimi Administrative Nr.09/2010, për përcaktimin e vendeve të punës dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar.
- Udhëzimi Administrative Nr.08/2012, për mënyrën dhe rregullat e mbajtjes së evidencës për punësimin e personave me aftësi të kufizuar.

Udhëzimi Administrativ për krijimin e punëtorive mbrojtëse dhe qendrave punuese i paraparë me Nenin 14, paragrafi 4, i Ligjit për Aftësim, Riaftësim Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuar, deri me tani nuk ka mundur të nxjerrët për shkak të vështirësive dhe ndikimet financiare në zbatimin e kësaj dispozite.

Themelimi i qendrave punuese dhe punëtorive mbrojtëse, të përcaktuar me ligjin në fuqi, e të cilat kanë për qëllim kryesisht punësimin e personave me aftësi të kufizuar në raste kur tregu i punës, nuk është i gatshëm t'i pranoj në ligjin aktual, këto qendra deri më tani nuk janë themeluar për arsye të kostos tejet të lartë financiare.

Rregullimi me ligj, do të bëhet kur të plotësohen kushtet për zbatimin e tyre, përkatësisht ndërtimi dhe funksionimi i këtyre qendrave varet nga grumbullimi i mjeteve financiare të cilat janë dedikuar PAK dhe nga ndarja e mjeteve nga buxheti i Kosovës, konkretisht pritet amendamentimin i Ligjit Nr. 03/L-019.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; Duke pohuar se unversialiteti, pandashmëria, ndërvarësia dhe ndërlidhja e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe nevojës së personave me aftësi të kufizuar për t'i garantuar ato pa diskriminim; Me qëllim të avancimit të pozitës socio-materiale dhe integritit në jetën e përditshme të Personave me aftësi të kufizuara; Me qëllim të zbatimit të drejtë të parimeve themelore dhe të drejtave universale nga marrëdhënia e punës, Miratoj **LIGJIN PËR AFTËSIMIN, RIAFTËSIMIN PROFESIONAL DHE PUNËSIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA.**

Me këtë ligj rregullohen dhe përcaktohen të drejtat, kushtet, mënyrat e aftësim, riaftësim profesional dhe punësimi i personave me aftësi të kufizuara, për integrimin e tyre në tregun e hapur të punës sipas kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në legjislacionin e aplikueshëm (Neni 1, Ligji për Aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e PAK-ut).

Qëllimi i këtij ligji është përkrahja ligjore dhe institucionale për aftësimin, riaftësimin, nxitjen dhe përgatitjen profesionale për punësim të përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuar duke u mbështetur në principet dhe tretmanin e mundësive të barabarta përfshirë edhe mundësitë gjinore (Neni 2, Ligji për Aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e PAK-ut).

Organet e administratës shtetërore, punëdhënësit e sektorit privat dhe publik si dhe organizatat joqeveritare obligohen që, me kushtet e përshtatshme të punës të punësojnë personat me aftësi të kufizuara (Neni 12, Paragrafi 1, Ligji për Aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e PAK-ut).

Çdo punëdhënës është i obliguar të punësoj një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor (Neni 12, Paragrafi 2, Ligji për Aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e PAK-ut).

Punëdhënësi i cili nuk i përmbush detyrimet nga paragrafi 1 dhe 2 i nenit 12 të ligjit bazik, obligohet që për nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara të

Monitorimi i zbatimit të ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar, Komuna e

Mitrovicës

paguajë në një xhirollogari të veçantë në vijën buxhetore të Buxhetit të Kosovës, pagesat mujore në lartësi të shumës së pagës minimale të realizuar në Republikën e Kosovës, për çdo person me aftësi të kufizuar që duhet të kishte punësuar (Neni 7, LIGJI NR. 05/L -078 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L 019 PËR AFTËSIMIN, RIAFTËSIMIN PROFESIONAL DHE PUNËSIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA).

QËNDRIMET E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR, FAMILJARËVE TË TYRE DHE AKTERËVE RELEVANT NGA INSTITUCIONET PUBLIKE, PRIVATE EDHE CIVILE NË LIDHJE ME GJENDJEN E PUNËSIMIT TË PAK-ut, PERCEPTIMET DHE SFIDAT E IMPLEMENTIMIT TË LIGJIT

Nga 600 anëtarët, persona me aftësi të kufizuar të Handikos Mitrovica janë si vijon:

- 18.33 % prej tyre nuk kanë vijuar shkollimin fare;
- 32 % prej tyre kanë përfunduar shkollën fillore;
- 40 % prej tyre kanë përfunduar shkollën e mesme;
- 3% prej tyre kanë përfunduar fakultetin, si dhe
- 6.67 % prej tyre kanë përfunduar zanate/kurse të ndryshme.

Dea Kurshumliu, 19 vjeqare, nga Mitrovica, një vajzë e menqur dhe me plot energji. Tani ka përfunduar shkollën e mesme dhe dëshira e saj për gazetari që nga fëmijëria ende mbizotëron dhe planifikon të vazhdoj studimet në Gazetari, dega e moderimit në television.

Dea është ri-kthyer aktiviteteve me Handikos Mitrovica me rastin e projektit “Pak nga vetja; shumë për PAK-un” të implementuar nga OJQ Handikos Mitrovica dhe përkrahur nga ATRC/USAID. Dea shprehet “Kur kam qenë e vogël mami im më ka dërguar në baza të rregullta në ushtrime në Handikos, pastaj e kam ndërpre unë vet....tani jam ri-kthyer në aktivitetet e Handikos Mitrovica, ndihem shumë e lumtur...”.

Dea është njëra prej 40 të përzgjedhurëve në projektin “Pak nga vetja; shumë për PAK-un” dhe në kuadër të aktiviteteve të para ka ndjekur 4 ditë trajnime në temat: Si të shkruajmë një CV dhe letër Motivuese, gjithashtu edhe në temat Aftësitë e Komunikimit dhe Prezantimit. Të gjitha këto tema kanë qenë të vlefshme për Dea-në sepse dëshira e saj për gazetari e ka shtyer që Dea të mendoj të rregjistrohet në fakultetin e gazetarisë dhe njohuritë e marrura nga këto trajnime e kanë bërë më të përgaditur fillimisht për ta aplikuar në praktikë në ndonjë prej radio-televizionet lokale e më pastaj edhe të gjejë një vend pune.

Shumë njerëz heqin dorë nga aplikimi ndoshta edhe në punën e ëndrrave të tyre vetëm e vetëm pse hezitojnë ta shkruajnë CV-në sepse kjo i’u duket punë e vështirë. Shkrimi i CV-së nuk është shumë i vështirë siç perceptohet nga një përqindje e njerëzve.

Dea pas përfundimit të trajnimeve është shprehur “Jam shumë e lumtur që kam marr pjesë në trajnimet e organizuara nga Handikos Mitrovica, po e ndjej vehtën më të privilegjuar dhe jam munduar që gjatë trajnimeve të jap kontributim tim në punët me grupe dhe besoj që sado pak ia kam arrit edhe pse me emocione...shpresoj dhe besoj që emocionet e mija ti menaxhoj më mirë si moderatore e ardhshme!”

Albert Baruti, 22 vjeçar, nga Mitrovica ka përfunduar shkollën e mesme të mjekësisë “Xheladin Deda” në Mitrovicë në drejtimin teknik I dhëmbëve. Alberti si djal shumë aktiv dhe me plot vullnet për punë, tani angazhohet si teknik I dhëmbëve në biznesin e nënës së vet.

Familja ka punuar shumë me Albertin dhe gjithmonë janë munduar ti plotësojnë dëshirat dhe planet e tij duke e angazhuar në shumë aktivitete të ndryshme të Handikos Mitrovica si dhe aktivitete tjera.

Alberti shprehet i kënaqur me pjesëmarrjen e tij në projektin “Pak nga vetja ; shumë për PAK-un” sepse tani është certifikuar për pjesëmarrjen në 3 setet e trajnimeve, shprehet “Për mua ka qenë kënaqësi të marr pjesë në aktivitetet e Handikos Mitrovica, tani I kam përforcuar njohuritë e mija se si shkruhet një CV, se si të paraqitemi sa më mirë në intervista pune, aftësitë e komunikimit dhe ndër-personale, gjithashtu

materialet e trajnimit kanë qenë shumë të dobishme që ti lexojmë edhe në shtëpi kur jemi...shumë faleminderit për mundësinë.”

Alberti nuk njih barrierë, me përkrahjen e familjes dhe shoqërisë, Alberti ka rregjistruar edhe fakultetin në Mitrovicë, drejtimin Teknologji e Përgjithshme. Dëshirat dhe ambiciet e Albertit nuk përfundojnë këtu, gjithmonë i matur dhe i menqur për planet e veta për të ardhmen.

Të dhënat e punësimit të personave me aftësi të kufizuar në Sektorin Publik, Privat dhe Civil (janë marr të dhënat e të punësuarve në 10 Institucione Publike, 38 Institucioneve Private dhe 15 Civile), janë si vijon:

- Nga 3105 të punësuar në Sektorin Publik, Persona me aftësi të kufizuar janë vetëm 7, apo 0.23%
- Nga 674 të punësuar në Sektorin Privat, Persona me aftësi të kufizuar janë vetëm 5, apo 0.74%
- Nga 95 të punësuar në Sektorin Civil, Persona me aftësi të kufizuar janë 12, apo 12.63%.

Bujar Kadriu, kryetar i Forumit Kosovar i Aftësisë së Kufizuar, thekson “Mos zbatueshmëria e ligjit është një sfidë e madhe, ligji për aftësim, riaftësim dhe punësim të PAK-ut është në fuqi prej vitit 2009, vet akterët institucional që e kanë aprovuar këtë ligj nuk e kanë zbatu. Mos zbatueshmëria e këtij ligji po prodhon varfëri tek Personat me Aftësi të Kufizuar. Në momentin kur punësohet një person me aftësi të kufizuar iu ndalet pensioni nga shteti dhe rikthimi është me shumë procedura, kjo prodhon një dualizëm ligjor, e cila e pamundëson punësimin e PAK-ut, një ligj e mundëson tjetri e sanksionon, kjo është shkelje e drejtave të njeriut, dhe padyshim që prodhon kundërefekte”.

Sebahate Beqiri, drejtoreshë e organizatës Doën Sindrom Kosova, thekson “Sfidat në implementimin e ligjit shihen sepse mungojnë mekanizmat për implementim e tij, tani vetëm është plotësu ligji, duhet të bëhen presione nga vet institucionet për ta zbatuar nga vet institucionet, me qëllim që institucionet të jenë mesazh i mirë për akterët e tjerë ta implementojnë ligjin (siq janë kompanitë private). Legjislacioni që është në fuqi nuk është i harmonizuar mirë, sepse ligji mbi skemat pensionale e ndalon punësimin në një

Monitorimi i zbatimit të ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar, Komuna e Mitrovicës

far mënyre PAK-un, përderisa ligji për aftësim dhe riaftësim iu ofron mundësi të punësimit, dhe kemi shumë raste që familja që ka një person me aftësi të kufizuar, heziton për të bashkëpunuar me shoqata në këtë proces për punësimin e PAK-ut, sepse punësimi në disa sektore nuk është i sigurt, në momentin e punësimit, ndalohej pensioni, dhe ka shumë procedura burokratike për ta rikthyer pensionin!”.

Të dhënat e perceptimit për punësim në Sektorin Publik apo Privat (janë marr të dhënat nga pyetësoret e realizuar me 40 persona me aftësi të kufizuar dhe 40 familjar të tyre), pyetja:

Nëse të ipet rasti të punosh në Institucione Publike (edhe pse jam i vetedishem që perkrahje sociale/pensioni invalidor nga shteti do të me ndërpritet)? Janë përgjegjur si vijon:

- “Po, pajtohem plotësisht”, janë përgjegjur me 75%
- “Me duhet përcjellje, transport, ushqim gjatë ditës, nuk kam llogari”, janë përgjegjur me 17.5%
- “Nuk e di”, janë përgjegjur me 7.5%.

Ndërsa në pyetjen:

Nëse më ipet rasti të punoj në Institucione Private, Biznese (edhe pse jam i vetëdijshëm që perkrahje sociale/pensioni invalidor nga shteti do të më ndërpritet)? Janë përgjegjur si vijon:

- “Më duhet përcjellje, transport, ushqim gjatë ditës, nuk kam llogari” janë përgjegjur me 18.5%
- “Jo, sepse munden të më largojnë nga puna, procedurat për rikthim në pensionin invalidor zgjasin shumë” janë përgjegjur 76.5%
- “Nuk e di” janë përgjegjur 5%.

Sadije Sadiku, person me aftësi të kufizuar, thekson “Nuk është problemi që ne nuk dëshirojmë me punë, por janë shumë rrethana që të kufizojnë, mua më është ofruar puna, por unë jetoj në Zhabar, 5 km larg qytetit të Mitrovicës, mua më është dasht me punë veq për taxi, sepse transport timin nuk kam, nuk kam llogari, duhem me shtu edhe para shtesë, nuk është që ne nuk dëshirojmë me punë, përkundrazi, sepse unë kam shumë dëshirë me dit se për cka po zgjohem në mengjes, me shku në punë, sepse te jep

edhe vullnet.”

Afrim Maliqi, drejtor i organizatës Handikos Kosova, thekson “Ndryshimi i ligjit të ri, ka ndëshkime për ato institucione apo kompani që nuk punësojnë PAK-un, është caktuar edhe linja buxhetore për mbledhjen e këtyre parave. Kryesisht punësohen në kompani privat, po ndikojnë shumë faktorë, transporti, ambienti, infrastruktura, pensioni, dhe në fund kur llogariten të gjitha këto, PAK-u po qëndron me pension sesa të kyqet në punë. Ligji për aftësim dhe punësim është në disavatazh me ligjin mbi pensionet e PAK-ut, sepse nuk e stimulon personin me kërku punë. Mirëpo ligji për para dhe tetra plegjik, kur fillon së zbatuari edhe nëse punon atëhere do ti marrin mjetet që i takojnë. Ligji është aprovu por nuk ka buxhet për zbatim.”

Arber Berisha, këshilltar ligjor në Institucionin e Avokatit të Popullit Mitrovicë, thekson “Ligji Nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e Personave me aftësi të kufizuara në nenin 12 parasheh punësimin në tregun e hapur të punës për këtë kategori. Sipas pikës 1 të nenit 12 të këtij ligji “Organet e administratës shtetërore, punëdhënësit e sektorit privat dhe publik si dhe organizatat joqeveritare obligohen që, me kushtet e përshtatshme të punës ti punësojnë personat me aftësi të kufizuara”. Poashtu pika 2 e nenit 12 të këtij ligji, përcakton se “Çdo punëdhënës është i obliguar të punësojë një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtorë”. Bazuar në informatat me të cilat Institucioni i Avokatit të Popullit disponon, pika 1 dhe 2 e nenit 12 të këtij ligji pothuajse në asnjë rast nuk është duke u zbatuar dhe asnjë person nuk është punësuar mbi bazën e këtij ligji. Personat me aftësi të kufizuar të cilët janë të punësuar kryesisht janë punësuar vetëm mbi bazën e meritave të tyre. Poashtu fatkeqësisht e njëjta gjendje si në gjithë Kosovën rezulton të jetë edhe në rajonin e Mitrovicës në komunitat (Mitrovicë, Skenderaj dhe Vushtrri)”.

Fitim Rama, Zyra për të Drejtat e Njeriut, Komuna e Mitrovicës, thekson “Në momentin kur punësohet një person me aftësi të kufizuar iu ndalet pensioni invalidor, shumë prej PAK-ut hezitojnë të kyqen në tregun e punës për shkak kontratave të shkurta për punë, ndalesa e pensionit invalidor, dhe procedurat për ri-aplikim për pension invalidor zgjasin

shumë. Andaj, të shtohen më shumë skemat programore nga Komuna dhe Ministrinë përkatëse për angazhimin e PAK-ut”.

Nysret Krasniqi, Qendra për Aftësim Profesional DIAKONIE Kosova, thekson “Janë shumë me rëndësi që të parashihen me ligj Punëtoritë Sociale ku OJQ-të të kishin pas mundësi të angazhojnë PAK-un dhe Qeveria ti subvencionoj pagat. Punësimi i PAK-ut nuk është vetëm punësim për ngritjen e të hyrave familjare por edhe në socializimin e PAK-ut në shoqëri. Të organizohen më shpesh debate, fokus grupe, tryeza dhe aktivitete për të diskutuar qështjet e PAK-ut dhe të rritet presioni ndaj insituvioneve relevante për implementim të ligjit në fuqi për PAK-un”.

Pra, nga këto disa të dhënat të lartpërmendura të raportit, mund të konstatojmë si në vijim:

- Është sfiduese shkollimi i personave me aftësi të kufizuar, është shqetësuesë që 18.33 % prej tyre nuk kanë vijuar shkollimin fare,
- Është pozitive rritja e % të personave me aftësi të kufizuar të certifikuar në zanate dhe kurse të ndryshme, kjo ndihmon në punësimin e tyre më te lehtë, këtu kanë ndihmuar shumë projektet e përkrahura nga donatorë të ndryshëm, siq është në këtë rast edhe ATRC/USAID,
- Nga mostra e këtij hulumtimi prej 3874 të punësuarve në Sektorin Publik, Privat dhe Civil janë Persona me Aftësi të Kufizuar vetëm 24. Pra nëse do të implementohet si duhet në përpikmëri Ligji Nr.03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar, në këto Institucione do të duheshin të punonin së paku 70 Persona me Aftësi të Kufizuar.
- Personat me Aftësi të Kufizuar kanë treguar më shumë interesim nëse do t’u ipet rasti të punojnë në Sektorin Publik sesa në at Privat, për shkak që sektori privat mund t’i largoj nga puna dhe procedurat për rikthim në pensionin invalidor zgjasin shumë.
- Ligji pothuajse në asnjë rast nuk është duke u zbatuar dhe asnjë person nuk është punësuar mbi bazën e këtij ligji. Personat me aftësi të kufizuar të cilët janë të punësuar kryesisht janë punësuar vetëm mbi bazën e meritave të tyre.

NDIKIMI I PROJEKTIT “Pak nga vetja; shumë për PAK-un” TEK PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Projekti “Pak nga vetja; shumë për PAK-un” propozuar nga Handikos Mitrovica është përkrahur nga Programi Angazhimi për Barazi -E4E me kohëzgjatje prej 12 muajsh (15 Shkurt 2016 – 14 Shkurt 2017) me qëllim të zgjerimit pjesëmarrjes së Personave me Aftësi të Kufizuar (PAK).

OJQ Handikos Mitrovica për ta realizuar qëllimin e projektit ka paraqitur dy objektiva specifike të cilat i konsideron si shumë të rëndësishme: **Objektivi specifik # 1:** 40 persona me aftësi të kufizuar (PAK) nga Rregjioni i Mitrovicës aftësohen për punë dhe bëhen konkurrentë në tregun e punës dhe promovojnë mundësitë e ndërmarjeve/institucioneve për sistematizim të PAK-ut. **Objektivi specifik # 2:** Monitorimi i zbatimit të ligjit Nr.03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar (duke u fokusuar në nenin 12. Pika 2: Çdo punëdhënës është i obliguar të punësojë një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor).

Rezultatet e projektit përgjatë një viti të programit:

- Janë njoftuar personat me aftësi të kufizuar për fillimin e projektit, komuniteti i gjerë në Mitrovicë me rrethinë ka marrë informatën për qëllimin dhe aktivitetet e projektit;
- Nënshkrimi i Memorandumeve të Mirëkuptimit në mes Handikos Mitrovica dhe Drejtorive përkatëse që merren me PAK-un të Komunës së Mitrovicës, Komunës së Vushtrrisë dhe Komunës së Skenderajit;
- Janë përzgjedhur 40 pjesëmarrësit e projektit;
- 40 persona me aftësi të kufizuar kanë marrë njohuri se si shkruhet një CV, një letër Motivuese, aftësitë e komunikimit/prezantimit dhe aftësitë ndër-personale;
- 40 persona me aftësi të kufizuar janë certifikuar me Certifikatë për Pjesëmarrje për 6 temat në 3 setet e trajnimeve të lartpërmendura në kuadër të projektit;

Monitorimi i zbatimit të ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar, Komuna e Mitrovicës

- 40 persona me aftësi të kufizuar marrin njohuri në zanate dhe kurse të ndryshme, 3 mujore, të ofruara nga dy qendrat profesionale në Mitrovicë, Qendra e Zanateve Gjermane Diakonia Kosova dhe Qendra për Aftësim Profesional në Mitrovicë në kuader të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- 40 persona me aftësi të kufizuar marrin njohuri në punët praktike 3 mujore në Institucionet Publike, Private dhe Civile;
- 30% prej tyre krijojnë marrëdhënie punë me gjysmë orari dhe disa raste edhe orar të plotë në ndërmarrje të ndryshme;
- Avokimi dhe lobimi përmes debateve, takimeve dhe focus grupeve me temën "Sfidat e implementimit të Ligjit për aftësim, riaftësim profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar";
- Bashkëpunimi me Institucionet relevante si proces i vazhdueshëm, marrja e të dhënave për zbatimin e ligjit Nr.03/L-019, publikimi i raportit me rekomandime.

REKOMANDIMET

1. Punësimi i personave me aftësi të kufizuar sipas Ligjit nr. 05/l -078 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/l-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara;
2. Hartimi i Ligjit për gjithpërfshirjen e Personave me Aftësi të Kufizuar;
3. Të shtohen shërbimet profesionale të logopedisë, fizioterapisë dhe të psikologut në sektorin publik shëndetësor;
4. Të ofrohen bursa të plota për specialistë në fushat specifike si logopedë, ergo-terapeutë dhe fizioterapeut;
5. Rritja e numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuar në sistemin e rregullt shkollor;
6. Punësimi i mësuesve mbështetës për fëmijët me aftësi të kufizuar në shkolla;
7. Zbatimi i Udhëzimit Administrativ Nr. 33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuar;
8. Ngritja e nivelit të vetëdijes të prindërve, familjarëve, institucioneve dhe shoqërisë në përgjithësi për personat me aftësi të kufizuar;
9. Krijimi i partneriteteve të qëndrueshme dhe afatgjatë me institucionet qendrore dhe lokale të vendit, në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe dinjitetin e personave me aftësi të kufizuar.

LISTA E SHKURTESAVE

OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
PAK	Person me Aftësi të Kufizuar

LISTA E PERSONAVE QË KANË KONTRIBUAR NË TAKIME, FOKUS GRUPE DHE NË INTERVISTA

Qazim Nimani - drejtor i Drejtorisë së Integriteteve Evropiane dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Mitrovicës

Sallah Bekteshi - menagjer i qendrës, Zyra për Punësim në Mitrovicë

Fitim Rama - Zyra për të Drejtat e Njeriut, Komuna e Mitrovicës

Arbër Berisha - këshilltar ligjor në Institucionin e Avokatit të Popullit, Mitrovicë

Nysret Krasniqi - Qendra për Aftësim Profesional DIAKONIE Kosova

Bujar Kadriu - kryetar i Forumit Kosovar i Aftësisë së Kufizuar

Sebahate Beqiri - drejtoreshë e organizatës Down Sindrom Kosova

Afrim Maliqi - drejtor i organizatës Handikos Kosova

Dea Kurshumliu - anëtare e Handikos Mitrovica

Sadije Sadiku - anëtare e Handikos Mitrovica

Albert Baruti - anëtar i Handikos Mitrovica